



Datë: 28.04.2025
Numër Protokolli: 2938/2025

A.nr.457/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.457/2025 të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.D., nga Podujeva, kundër organit të punësimit/Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.457/2025, e datës 12.03.2025, e parashtruar nga ankuesi, Sh.D.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli AKF/2025-048, i datës 04.03.2025.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Sh.D.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 12.03.2025ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1616/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.457/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër protokolli AKF/2025-048, i datës 04.03.2025, Zv. Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 17.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ndërsa kjo e fundit më datë 21.03.2025, ka dorëzuar përgjigjën me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*), pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1616/2025, të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli AKF/2025-048 të datës 04.03.2025; Vendimin me Nr.0122/2024 të datës 28.02.2024; E-mailin e datës 05.03.2025; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 21.03.2025; Kontratën e punës të

ankuesit, të datës 22.07.2013; Sqarimin me numër reference AKF/2025-051, të datës 21.03.2025; E-mailin e datës 21.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse*:

Nga provat materiale të çështjes Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 22.07.2013, është i punësuar Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, përkatësisht në pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Cilësi*.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rrjedhë së më datë 04.03.2025, Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli AKF/2025-048, përmes të cilit akt ankuesin e ka caktuar zëvendësues të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor në organin përkatës të punësimit, për shkak konfliktit të mundshëm të interesit lidhur shqyrtimin e procedurës disiplinore. Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli AKF/2025-048 të datës 04.03.2025, duke theksuar se nxjerrja e vendimit kontestues është në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, ka gjetur se aktin e kontestuar, përkatësisht Vendimin mbi caktimin e ankuesit në cilësinë e zëvendësuesit të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor, në organin përkatës të punësimit, është nxjerrë nga Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë më datë 04.03.2025, mirëpo kontestues është fakti se i njëjti përmes Vendimit me numër protokolli 0122 të datës 28.02.2024, të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht sipas pikës I të dispozitivit nga pozita ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit për Traseologji Forenzike, është caktuar në pozitën përkatëse dhe atë në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës, i cili akt sipas pikës IV të dispozitivit ka hyrë në fuqi më datë 01.03.2024.

Andaj, Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me çështjen e emërimit dhe mandatin në cilësinë e ushtruesit të detyrës, ju referua dispozitave përkatëse që rregullojnë këtë çështje nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, gjegjësisht nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 1. *Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë.* 2. *Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.* 3. *Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.* 4. *Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.* 5. *Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm, dhe për rrjedhojë konstatoi se z. I.K me këtë rast, ka tejkaluar afatin e përcaktuar mbi dispozitat e sapo theksuara për ushtrimin e pozitës si ushtrues detyre, ashtu që çdo veprim i tij jashtë këtij afati konsiderohet i paligjshëm dhe nuk prodhon pasoja juridike.*

Kështu që, nisur nga fakti i pa kontestueshëm se organi i cili ka nxjerrë vendimin kontestues, më datë 01.03.2025 ka përfunduar mandatin e Ushtruesit të Detyrës në cilësinë e titullarit të organit përkatës të punësimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, ngase Vendimi me numër protokolli AKF/2025-048 i datës 04.03.2025, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e lartë theksuara ligjore dhe se i njëjti është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 4 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase përpiluesi i këtij akti nuk kishte

mandat dhe autorizim ligjor për ushtrimin e kësaj pozite gjegjësisht atë të “*Kryeshefit Ekzekutiv*”, ndaj si rrjedhojë vendosi të shfuqizoj të njëjtin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.457/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Sh.D;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.